

KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	26/05	20 ^{to}	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	06061	15326	

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: <u>20.05.2020</u>
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 3 <u>Takim i rregullt</u> / Redovni sastanak <input checked="" type="checkbox"/> Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak <input type="checkbox"/>
Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>15</u>
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku? Po / Da <input type="checkbox"/> Jo / Ne <input type="checkbox"/> Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice <input checked="" type="checkbox"/>
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku? Po / Da <input checked="" type="checkbox"/> <i>KFOR-LMT K9.</i> Jo / Ne <input type="checkbox"/> <i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju</i>
A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik? Po / Da <input checked="" type="checkbox"/> Kryetari Jo / Ne <input type="checkbox"/>
Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu: Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të KKSBB-së të mbajtur me 12.03.2020; 2. Njoftim për masat e ndërmarra nga Komuna e Drenasit prej datës 13 mars deri më tani për parandalim të virusit COVID-19; 3. Të ndryshme. <i>Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:</i>

Konkluzionet / Zaključci:

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) ka mbajtur mbledhjen e dytë të rregullt për këtë vit të cilën e kryesoi kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci.

Të pranishëm ishin shumica e anëtarëve e KKSBB-së, dhe përfaqësues nga KFOR-LMTK9.

Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur më 12.03.2020 u miratua unanimisht, pa vërejtje.

Sa i përket pikës së dytë kryetari Lladrovci i njoftoi të pranishmit me veprimet e ndërmarra nga Komuna që nga data 13 mars, kur u shpall situata e emergjencës shëndetësore në Kosovë. Ndër të tjera, kryetari tha se komuna me kohë ka krijuar Shtabin Emergjent, pastaj Nënshtabet Lokale për të vazhduar pastaj me Qendrën Operative Lokale Emergjente. Sa i përket shërbimeve komunale, edhe pse me numër të reduktuar, qytetarët kanë marrë shërbimet e domosdoshme në Komunë.

Kryetari Lladrovci i njoftoi të pranishmit për edhe për masat e marra për përkujdesje nga Komuna dhe tha se nga buxheti komunal janë kontraktuar dhe shpërndarë 2600 pako ushqimore për familjet nevojtare. Gjatë kësaj kohe ka pasur edhe shumë donacione të ndryshme për të cilat i falënderoj publikisht për gjestin vullnetmirë të tyre, tha Lladrovci.

Gjatë kësaj kohe, policia ka qenë në nivel të detyrës dhe me përkushtimin më të madh kanë kryer detyrat e tyre. Edhe zjarrfikësit kanë pasur shumë punë duke qenë se ka pasur shumë zjarre të qëllimshme të cilat u kanë krijuar shumë vështirësi ekipeve zjarrfikëse duke pasur parasysh stafin në numër të vogël. Edhe Kompania Pastrimi, Ujësjiellësi dhe shërbimet e KEDS kanë qenë në nivel të pritjeve dhe detyrave.

Për këtë pikë nga Bashkësia Islame fjalën e mori Beqir Thaçi. Ndër të tjera ai tha se si Këshill i Bashkësisë Islame janë përpjekur që krahas ndihmave në pako ushqimore për qytetarët e Drenasit të përçojnë kërkesat dhe këshillat e IKSHP-së dhe OBSH-së.

Për pikën të ndryshme, Meriton Sopi, përfaqësues i Komunitetit Katolik shprehu pakënaqësinë që disa portale të njohura, me çdo kusht tentojnë të përfshijnë Kishën në Llapushnik në raste me konotacione negative dhe kërkoi nga policia që të marrin masat e nevojshme dhe të kërkohet sqarim se pse po ndodh kjo.

Njëra ndër çështjet tjera të ngritura në takim ishte se ka rritje të vjedhjeve, gjë e cila u demantua nga policia në mënyrë statistikore. Për vite të tëra nuk ka pasur vjedhje kaq të vogla në numër, ndërsa për disa raste që kanë ndodhur jemi në përfundim të hetimeve, tha Feime Bajrami, komandante e Stacionit Policor në Drenas.

Anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi përshëndeten masat e marra nga Komuna për këtë çështje.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSBS-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Arben Shala
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:
Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrovc

nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 26.05.2020

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSBS-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSBS-së.

